AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), 2025


19.06.2026

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2025

## Më shumë sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore në 2025 sesa në 2024

Të dhënat tregojnë se sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzuar e tokës bujqësore u rrit për 510,90 ha (0,1%) në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024.

**Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2024- 2025**




### Rritje e lehtë vërehet te toka e përbashkët

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2025, pjesa më e madhe u përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) ishte 216 697,39 ha krahasuar me vitin paraprak 2024 (që ishte 216 534,33 ha).Rritja e sipërfaqes te toka e përbashkët si rezultat i rritjes se numrit të blegtorisë.

**Rritje e lehtë vërehet te drithërat dhe perimet**

Toka e punueshme - arat marrin pjesë me 45.0% në gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore dhe kopshtet me 0,2%.

Gjatë vitit 2025, gjithsej toka e punueshme – arat, ishte 189 131,22 ha, pjesa më e madhe ishte me: drithëra (128 190,63ha, ose 67,8%); bimë foragjere (36 446,35ha, ose 19,3%); perime 9 841,44

ha në fushë të hapur, në serra dhe kopshte (prej të cilave perime në fushë të hapur dhe serra ishin 8 946,37ha, ose 4,7%); patate (3 375,16ha, ose 1,8%); bishtajore (2 257,45ose 1,2%); bimë industriale ( 1 254,60ha, ose 0,7%); kultura të tjera (2 556,27ha, ose 1,4%) dhe tokë djerrinë ishte 6 104,38 ha ose 3,2%.

Sipërfaqe e ujitur, të paktën një herë gjatë periudhës referuese të anketës në vitin 2025, ishte 34 240,28 ha.

Kurse, gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide në vitin 2025 ishte 123 045,50 ha.


**Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2025 - 2024 (ha)**

| Shfrytëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive | Sipërfaqja (ha) 2024 | Sipërfaqja (ha) 2025 |
|---|---|---|
| Tokë e punueshme - ara | 188 795,00 | 189 131,22 |
| Kopshte | 912,75 | 895,07 |
| Plantacione të pemëve | 10 408,21 | 10 481,08 |
| Plantacione të vreshtave | 3 405,54 | 3 343,21 |
| Fidanishte | 172,86 | 191,61 |
| Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) | 216 534,33 | 216 697,39 |
| **Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore** | **420 228,67** | **420 739,57** |

## Rritje e lehtë e fondit blegtoral

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se blegtoria në Kosovë, gjatë vitit 2025, sa i përket numrit të gjedheve ishte 241 423, ku krahasuar me vitin paraprak 2024 (që ishte 240 848), ka një rritje të lehtë.

### Numri i kafshëve sipas llojeve 2024 – 2025




### Rritje e lehtë vërehet te numri i deleve

Sa i përket numrit të deleve gjatë vitit 2025 ishte 211 178, ku krahasuar me vitin paraprak 2024 (që ishte 209 947), vërehet një rritje e lehtë.

### Numri i kafshëve sipas llojeve 2024 - 2025

| Viti | Gjedhet | Delet | Dhitë | Derrat | Njëthundrakët | Shpezët | Numri i kosherëve të bletëve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2024 | 240 848 | 209 947 | 27 197 | 44 082 | 1 377 | 3 034 318 | 221 922 |
| 2025 | 241 423 | 211 178 | 27 364 | 44 591 | 1 327 | 3 201 767 | 228 454 |

Ky publikim ofron të dhëna në formë përmbledhëse për kulturat bujqësore bimore (shfrytëzimin e tokës bujqësore, prodhimtarinë bimore, inputet bujqësore (plehrat minerale, organike, pesticidet); blegtorinë: therjet, shitjet, produktet blegtorale dhe shpenzimet në ekonomitë bujqësore.

Metodologjia dhe standardet e aplikuara në AEB 2025 (përkufizimet – definicionet, pyetësori, dhe udhëzuesi) janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostatit.Për më shumë informata, lidhur me rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore(AEB) 2025, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/bujqesi/anketa-e-ekonomive-shtepiake-bujqesore